



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 08/2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, (PZAP) në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Xhevdet Abazi, Nehat Idrizi, Rafet Haxhaj, dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e parashtuara për parregullsitë në procesin e votimit të datës 09 Janar 2011 në komunat: Deçan, Glllogovc, Malishevë dhe Skenderaj, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të paraqitura nga subjektet politike: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarëve Hulumtues (BIRN), në seancën e mbajtur më 13.01.2011, mori këtë;

**V E N D I M**

**I. PRANOHEN** të bazuara ankesat për komunat: Deçan, Glllogovc, Malishevë dhe Skenderaj, dhe atë me numrat si vijon: A. nr. 08; 09; 10; 12; 13; 16 e plotësuar me nr.78; 17; 20; 24; 25; 45; 46; 50; 53; 54; 55; 56; 57; 58; 64; dhe 66 ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror Zgjedhor (**KQZ**) të rinumëroi procesin e rivotimit në:

- Qendra e Votimit (QV) 2104b Vendvotimin (VV)/01R - Ankesa nr. 10/2011
- QV 2106b - VV 01R - Ankesa nr.13/2011;
- QV 2105b - VV 03 - Ankesa nr.24/2011;
- QV 2117b - VV 02 - Ankesa nr.25/2011, të gjitha në komunën e Skenderajt, si dhe;
- QV 0106c - VV 01R/02R dhe 03R - Ankesa nr. 55 dhe 57/2011komuna e Deçanit, dhe;
- QV 0310e - VV 04D - Ankesa nr.56/2011, komuna e Glllogovcit.

**II. U NDALOHET** komisionarëve të Qendrave të mëposhtme të Votimit të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme nën autoritetin e KQZ si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore prej 3 (vite), nga dita e shqiptimit të kësaj ndalese:

**Komuna e Skenderajt:**

A. nr: 10/ 2011 – 2104b; A. nr: 13/2011 – 2106b; A. nr: 16 dhe 78/2011 – 2124b; A. nr: 17 dhe 25/2011 – 2117b; A. nr: 20 dhe 66/2011 – 2110b; A. nr: 24/2011 – 2105b; A. nr: 45/2011 – 2128b; A. nr: 58/2011 – 2116b; A. nr: 64/2011 – 2101x;

**Komuna e Deçanit:**

A. nr: 8, 9, 12, 46, 55 dhe 57/2011 – 0106c; A. nr: 53/2011 – 0101c;

**Komuna e Gllgovcit:**

A. nr: 54/2011 – 0306e; A. nr: 56/2011 – 0310e;

**Komuna e Malishevës:**

A. nr: 50/2011 – 3008a;

**A r s y e t i m**

Pas përsëritjes së procesit të ri-votimit më 9 Janar 2011 në Komunitet e përmendura në dispozitiv të këtij vendimi, PZAP-i ka pranuar ankesa nga subjektet politike saktësisht të theksuara në hyrje të këtij vendimi lidhur me mashtrimet, pa rregullsitë dhe gabimet tjera gjatë procesit zgjedhor me rastin e ri-votimit dhe numërimit në qendra të votimit dhe vendvotime të ndryshme në komunën e Skenderajt, Deçanit, Gllgovcit dhe Malishevës.

Parashtruesit e ankesave në ankesat e tyre kanë cekur se në shumë vendvotime ka pasur vjedhje votash, blerje të komisionarëve, falsifikime të nënshkrimeve, kërcënimeve, mbushje të kutive të votimit, votime familjare, presione dhe shantazhe etj. Kështu, subjektet politike të theksuara saktësisht në dispozitiv të vendimit pretendojnë për parregullsi të kryera në qendrat e votimit dhe në vendvotime me propozim që PZAP-i të ndërmarr masa të caktuara në kuptim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për shkak se këto parregullsi kanë pasur ndikim në rezultatet finale.

Me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të punës në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurës të PZAP-it, Paneli ka vendosur ti bashkon ankesat e parashtruara të cilat kanë përmbajtje të ngjashme, ashtu që Paneli të gjitha ankesat e parashtruara i ka shqyrtuar dhe ka marrë vetëm një vendim.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L-256) të datës 29 tetor 2010 i ka shqyrtuar dhe hetuar pretendimet ankimore, provat që gjinden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë e tyre reciproke si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara, ka gjetur se:

**- ankesat janë të bazuara**

Në bazë të nenit 115.1 të LZP në Republikën e Kosovës, saktësisht parashihet se PZAP-i është organi i përhershëm i pavarur dhe ka kompetencë për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet të cilat kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Nga kjo dispozitë qartë rrjedhë se PZAP-i ka kompetencë për të vendosur vetëm përkritazi me ankesat dhe apelet që i referohen procesit zgjedhor, kështu që PZAP-i nuk ka kompetencë që në bazë të detyrës zyrtare të shqyrton dhe vlerëson procesin zgjedhor lidhur me të cilin nuk është paraqitur ankesë ose apel.

Në bazë të nenit 106.2 të LZP-së saktësisht parashihet se KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve në çdo vendvotim, qendër të numërimit, ose edhe të urdhëroj përsëritjen e votimit në një qendër të votimit apo në një komunë. Në bazë të kësaj dispozite qartë është përcaktuar kompetenca e KQZ-së që para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të urdhëroj rinumërimin e votave ose përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë. Në bazë të këtyre dispozitave në mënyrë të sigurt dhe të qartë janë përcaktuar kompetencat e PZAP-it dhe KQZ-së.

Nga provat në shkresa të lëndës dhe nga rezultati i hetimit të kryer nga paneli i PZAP-it, e pas analizimit dhe vlerësimit të gjithanshëm të provave, PZAP-i vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në bazë të kompetencave të veta ligjore, KQZ më datë 12 Janar 2011 ka urdhëruar ri-numërimin e 92 vendvotime në Skenderaj, Gllogovc, Malishevë dhe Deçan si rezultat i procesit të ri-votimit të mbajtur më 9 Janar 2011, me të cilat vendvotime nuk kanë të bëjnë vendvotimet e cekura në dispozitiv të këtij vendimi, e për të cilat me këtë vendim është urdhëruar ri-numërimi nga PZAP.

Në bazë të raportit të hetuesve të angazhuar nga PZAP-i, të cilët kanë përcjell dhe hetuar parregullsitë e theksuara në ankesat e cekura më lartë, nga shikimi dhe vlerësimi i Listës Përfundimtare të Votuesve (LPV) dhe Librave të Votimit, konstatimi i fakteve të mashtrimit, hetimet në analizën e nënshkrimeve në LPV dhe Formularin e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve si dhe nga kontrolli i FPR-ve dhe nga fotokopjimet e materialeve relevante, lidhur me parregullsitë e pretenduara janë konstatuar parregullsi që i referohen nënshkrimit nga ana e një personi për shumë votues, nënshkrimi i një kryefamiljari për disa anëtarë të familjes, për shkak se ky nënshkrim në listën e votuesve qartë vërehet se është nënshkrim i të njëjtit person, etj. Këto parregullsi të nënshkrimeve përfaqësojnë shkelje të përcaktuara me nenin 91.2 të LZP dhe se kjo shkelje përbën vepër penale dhe është e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës. Në bazë të nenit 1.12 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP, të gjitha rastet e përgjegjësi individuale që kanë të bëjnë me shkeljen e Kodit Penal të Kosovës, do të dërgohen në zyrën e Prokurorit të Shtetit për hetime të mëtutjeshme. Në bazë të rregullave zgjedhore të KQZ-së 9/2009 - neni 11.4 është paraparë se nëse emri dhe mbiemri i votuesit gjendet në LPV pa një shenjë ose shënim, votuesi duhet të udhëzohet të nënshkruhet në LPV pranë emrit të tij apo të sajë.

Në këtë kontekst, nga rezultatet e hetimit përkitazi me komunën e Skenderajt potencohet fakti se këto parregullsi qëndrojnë si vijon:

- nga **49.320** votues me të drejtë vote, PZAP ka konstatuar 324 nënshkrime të parregullta, që në përqindje rezulton se është më pak se 1 %, apo saktësisht 0.65%;

- në komunën e Deçanit nga **37.244** votues me të drejtë vote, PZAP ka konstatuar 45 nënshkrime të parregullta, që në përqindje rezulton se është më pak se ¼ e 1 %, saktësisht 0.12%;

- në komunën e Gllogovcit nga **46.657** votues me të drejtë vote, PZAP ka konstatuar 92 nënshkrime të parregullta, që në përqindje rezulton se është më pak se ¼ e 1 %, saktësisht 0.2%;

Për më tepër, PZAP ka konstatuar se në të gjitha vendvotimet e hetuara në komunat e lartpërmendura, të gjitha FPR-të kanë qenë të nënshkruara nga komisionerët e partive politike të pranishëm në vendvotime, si dhe në shumicën e Librave të Votimit nuk janë konstatuar shkelje serioze të pretenduara në ankesat e adresuara në PZAP. Po ashtu, si pjesë e procedurës hetimore, PZAP ka pranuar raportet e Stacioneve Policore të datës 11 Janar 2011 në komunat përkatëse, të cilat kanë konstatuar se procesi i ri-votimit është zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe pa incidente serioze, të cilat do të mund të ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Neni 120.1 nënpika b) i LZP-së parasheh se: *në rast se para certifikimit të rezultateve zgjedhore ka ndodhur ndonjë shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së, është në kompetencë të PZAP-it që në raste të jashtëzakonshme të anulohet rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi dhe ta urdhërojë KQZ-në të përsëris votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale.*

Nga kjo dispozitë rrjedh se PZAP ka mundësi dhe kompetencë t'i anulohet rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi dhe ta urdhërojë KQZ-në të përsëris votimin në një qendër votimi apo vendvotim. Mirëpo, për anulimin e rezultateve dhe dhënien e urdhrit të KQZ-së për përsëritjen e votimit, duhet të vërtetohet fakti vendimtar se a kishin këto parregullsi ndikim në rezultatet finale. PZAP duke u bazuar në provat e nxjerra krijoi një pasqyre reale të gjendjes së çështjes e përshkruar më lartë dhe mbi këtë bazë mori qëndrim se këto parregullsi nuk kanë ndikim në rezultatet finale dhe për këtë arsye ka vlerësuar se nuk duhet të anulohen

rezultatet dhe të urdhërohet KQZ-ja të përsëris votimin. Me dispozitën e lartcekur saktësisht parashihet se anulimi dhe urdhri për përsëritjen e votimit mund të bëhet, nëse PZAP konsideron se parregullsitë kanë ndikim në rezultatet finale, në rastin konkret ky kusht ligjor nuk ekziston. Këtë vlerësim PZAP e mori për arsye se me ndërmarrjen e kësaj mase të theksuar në dispozitiv (ri-numërimin), do të evitohen parregullsitë e konstatuara sikurse në dispozitiv, ndërsa ato që nuk mund të evitohen me ri-numërim janë pa ndikim në rezultatet finale.

Pika e dytë e dispozitivit që ka të bëjë me ndalimin e komisionerëve të qendrave të votimit të përshkruara më lartë, është marrë në bazë të Nenit 120.3, nën-pika d) të LZP-së, në të cilën saktësisht është paraparë se në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve, PZAP ka kompetencë që t'i ndaloj ndonjë individ të marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite. Kjo përfaqëson një sanksion shtesë nga ana e PZAP-it, e të cilën mund ta shqipton edhe sipas detyrës zyrtare, dhe se kohëzgjatja e kësaj ndalese është në pajtim me peshën e parregullsive të konstatuara më lartë.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Nga të cekurat më lartë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi e në bazë të neneve: 115.1, 117.2, 117.3, dhe 120.1 nën pikën b). të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/L-256) të datës 29 tetor 2010).

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**

**A nr.08 /2011 me datë 13.01.2011**



**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**